



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. ___ prot.

Tiranë, më 02.2026

Lënda: Raporti i monitorimit të shpenzimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2025.

Ministria e Mbrojtjes administron dhe menaxhon fondet publike, sipas shtatë programeve buxhetore të miratuara, konkretisht:

- 1) Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”;
- 2) Programi “Forcat e Luftimit”;
- 3) Programi “Mbështetja e Luftimit”;
- 4) Programi “Arsimimi Ushtarak”;
- 5) Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”;
- 6) Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët”;
- 7) Programi “Emergjencat Civile.

Për vitin 2025 realizimi i shpenzimeve të buxhetit sipas secilit program, krahasuar me planin me ndryshime të periudhës raportuese, paraqitet, si më poshtë:

Tabela nr. 1

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi i programit	Plani i rishikuar viti 2025	Shpenzime faktike viti 2025	Përqindja kundrejt vitit në %
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,673,933	1,656,803	99
2.	Forcat e Luftimit	18,074,255	17,381,335	96
3.	Mbështetja e Luftimit	9,978,226	9,629,529	97
4.	Mbështetja për Shëndetësinë	1,919,440	1,902,997	99
5.	Arsimimi Ushtarak	1,451,802	1,342,871	92
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,228,958	5,228,958	100
7.	Emergjencat Civile	2,986,859	2,400,317	80
	Totali i Shpenzimeve të Ministrisë	41,313,473	39,542,809	96

Niveli i realizimit është masën 96 %, për shkak të mosplotësimit të strukturës organike dhe moskryerjes në kohë të procedurave të prokurimit në shpenzimet kapitale, si dhe mosrealizimi i fondeve në artikullin ekonomik 604 “Transfertat Korrente të Brendshme” dhe art. 231 shpenzime “Kapitale të Trupëzuara” nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në llogaritë ekonomike të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, mosrealizimi i fondeve është përgjegjësi e tyre. Financimi i Brendshëm është realizuar në masën 90%.

Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët” paraqitet me realizim 100%, programet “Mbështetja për Shëndetësinë” me nivel realizimi 99% dhe “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” rezulton me

realizim 99%, programi “Mbështetja e Luftimit” me nivel realizimi 97%, programi “Forcat e Luftimit” me nivel realizimi 96%, Programi “Arsimimi Ushtarak” rezulton me realizim 92%, ndërsa me realizim më të ulët paraqitet programi “Emergjencat Civile ” me nivel realizimi 80%.

❖ INFORMACION MBI BUXHETIN

Sipas zërave të shpenzimeve buxhetore vetëm me financim të brendshëm, duke përjashtuar edhe të ardhurat jashtë limitit, niveli i realizimit është 96 % dhe situata për çdo program për vitin 2025 paraqitet e tillë:

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzime korrente, realizimi është në masën 99%.
- Shpenzime kapitale me Financimi i Brendshëm, realizimi është në masën 90%.
- Shpenzime kapitale me Financim i Huaj, realizimi është në masën 0%,

Tabela nr. 2

Nr.	Emërtimi i programit	Shpenzime korrente Viti 2025 në përqindje	Shpenzime kapitale të brendshme Viti 2025 në përqindje	Totali i shpenzimeve buxhetore Viti 2025 në përqindje
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	99	100	99
2.	Forcat e Luftimit	99	93	96
3.	Mbështetja e Luftimit	99	89	97
4.	Mbështetja për Shëndetësinë	99	98	99
5.	Arsimimi Ushtarak	96	86	92
6.	Mbështetje për Ushtarakët	100	-	100
7.	Emergjencat Civile	92	73	80
TOTALI I MINISTRISË		99	90	96

Për të gjitha programet në nivel ministrie realizimi i **shpenzimeve korrente paraqitet me 99%**, duke variuar nga më i ulëti programi “Emergjencat Civile” me nivel realizimi 92 %, programi “Arsimimi Ushtarak” me nivel realizimi 96 %, Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” rezulton me realizim 99%, programi “Mbështetja e Luftimit” me nivel realizimi 99 % programi “Forcat e Luftimit” me nivel realizimi 99% dhe programi Mbështetja për Shëndetësinë” me nivel realizimi 99 %, deri te programet me nivel realizimi 100% “Mbështetje për Ushtarakët”.

Në mosrealizimin në nivelin e planifikimit të shpenzimeve për Ministrinë e Mbrojtjes ka ndikuar mosrealizimi në shpenzime për paga si pasojë e mosplotësimit të strukturave të miratuara në të gjithë programet. Mosrealizimi në nivelin e planifikuar në shpenzime kapitale, si dhe për mallra dhe shërbime ka ardhur si rrjedhojë e zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Në zërin e shpenzimeve kapitale të brendshme, Ministria paraqitet me realizim prej 90% ndaj planit 12-mujor, ku theksojmë se nga ana e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes janë realizuar procedurat e prokurimit sipas projekteve të miratuara, në mosrealizim të fondeve në artikullin shpenzime Kapitale me financim të brendshëm kanë ndikuar transfertat e kryera nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në llogaritë ekonomike të njësive të vetëqeverisjes vendore, mosrealizimi i të cilave është përgjegjësi e tyre, si dhe mosrealizimi i procedurave të dërguara te AKSHI.

Duke iu referuar Aneksit nr.1 të monitorimit për shpërndarjen e buxhetit ndër 7 programet e ministrisë, më poshtë po paraqesim strukturën e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar, buxhetit me ndryshime në nivel vjetor dhe faktit të realizuar gjatë vitit 2025.

Tabela nr. 3

Nr.	Emërtimi i programit	Struktura e shpenz. sipas buxhetit fillestar Viti 2025 në përqindje	Struktura e shpenz. sipas faktit të Vitit 2025 në përqindje
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2.9	4.2
2.	Forcat e Luftimit	54.8	44.0
3.	Mbështetja e Luftimit	15.8	24.4
4.	Mbështetja për Shëndetësinë	3.6	4.8
5.	Arsimimi Ushtarak	2.7	3.4
6.	Mbështetje për Ushtarakët	9.9	13.2
7.	Emergjencat Civile	10.4	6.1
	Totali i Shpenzimeve të Ministrisë	100	100

Shpenzime sipas faktit të vitit 2025 në përqindje sipas programeve buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes.

Rreth 44% të totalit të shpenzimeve faktike të kryera gjatë vitit 2025 e zë programi “Forcat e Luftimit”, ndjekur nga shpenzimet për programet “Mbështetja e Luftimit” me 24.4%, “Mbështetje për Ushtarakët” me 13.2%, “Emergjencat Civile” me rreth 6.1%, “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” me 4.2%, “Mbështetja për Shëndetësinë” me 4.8% dhe “Arsimimi Ushtarak” me 3.4%”.

Nga monitorimi konstatohet se struktura e shpenzimeve ndërmjet programeve sipas buxhetit fillestar dhe buxhetit me ndryshime, konstatohen ndryshime programet konkretisht:

1. “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 0.2 pikë më e lartë.
2. “Forcat e Luftimit”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 0.2 pikë më e ulët.
3. “Mbështetja e Luftimit”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 2.9 pikë më e lartë.
4. “Mbështetja për Shëndetësinë”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar nuk paraqitet me ndryshime.
5. “Arsimimi Ushtarak”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar nuk paraqitet me ndryshime.
6. “Mbështetje për Ushtarakët”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 0.1 pikë më e ulët.
7. “Emergjencat Civile”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 2.9 pikë më e ulët.

Struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar të Ministrisë së Mbrojtjes në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 1.4 pikë më e lartë.

Ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në planin përfundimtar pa përfshirë investimet me financim të huaj, niveli i realizimit në vlerë sipas strukturës së tyre për vitin 2025 paraqitet, si më poshtë:

Tabela nr. 4

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i programit	Plani vjetor i rishikuar	Struktura në përqindje	Fakti i vitit 2025	Struktura në përqindje	Realizimi në përqindje
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,673,933	4.1	1,656,803	4	99
2.	Forcat e Luftimit	18,074,255	43.7	17,381,335	44	96
3.	Mbështetja e Luftimit	9,978,226	24.2	9,629,529	24	97
4.	Mbështetja për Shëndetësinë	1,919,440	4.6	1,902,997	5	99
5.	Arsimimi Ushtarak	1,451,802	3.5	1,342,871	3	92
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,228,958	12.7	5,228,958	13	100
7.	Emergjencat Civile	2,986,859	7.2	2,400,317	6	80
	Totali	41,313,473	100	39,542,809	100	96

Ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në planin përfundimtar duke përfshirë investimet me financim të huaj, në nivel programi dhe artikulli paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 5

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i programit	Plani fillestar	Plani i rishikuar	Ndryshimi i planit vjetor
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,523,300	1,673,933	150,633
2.	Forcat e Luftimit	28,853,758	29,176,655	322,897
3.	Mbështetja e Luftimit	8,313,436	9,978,226	1,664,790
4.	Mbështetja për Shëndetësinë	1,906,000	1,919,440	13,440
5.	Arsimimi Ushtarak	1,427,000	1,451,802	24,802
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,200,000	5,228,958	28,958
7.	Emergjencat Civile	5,462,050	3,998,909	-1,463,141
	TOTALI I MINISTRISË	52,685,544	53,427,923	742,379

Në total ministrie, ndryshimi i buxhetit të vitit 2025 paraqitet me rritje në vlerën **742,379** mijë lekë nga buxheti fillestar, ose në masën 1.4 %.

Në ndryshimet e planit të rishikuar të buxhetit në krahasim me planin fillestar.

Këtë ndryshim po e analizojmë sipas artikujve të secilit program:

1. Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”

Në total për vitin 2025 kemi rritje të buxhetit në shumën 150,633 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar, sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601 kemi shtesë fondi në shumën 81,000 mijë lekë, për plotësimin e detyrimeve në këtë artikull, si efekt i rritjes së pagave për ushtarakët.

Në artikullin 602 kemi shtesë fondi në shumën 135,000 mijë lekë shtesë fondi me akt normativ për likuidimin e detyrimeve në këtë artikull.

Në artikullin 605 kemi pakësim fondi në shumën 35,000 mijë lekë, për pagesën e kuotizacionit në organizatat ndërkombëtare (NATO).

Në artikullin 606 kemi shtesë fondi në shumën 11,964 mijë lekë, që ka të bëjë me detajimin fillestar të fondit të veçantë për pagesën e ndihmave të menjëhershme dhe kompensime të tjera.

Në artikullin 231 kemi pakësim fondi në shumën 42,331 mijë lekë.

2. Programi “Forcat e Luftimit”

Në total për vitin 2025 kemi shtesë të buxhetit në shumën **322, 897** mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm (përfshirë investimet kapitale me financim të huaj):

Në artikullin 600 dhe 601 kemi shtesë fondi në shumën 1,099,636 mijë lekë.

Në artikullin 602 kemi shtesë fondi në shumën 660,000 mijë lekë.

Në artikullin 606 kemi shtesë fondi në shumën 26,241 mijë lekë.

Në artikullin 231, kemi pakësim fondi në Investime kapitale me financim të brendshëm në vlerën 2,365,380 mijë lekë nga të cilat:

Shtesë në investimet kapitale me financim të huaj në vlerën 902,2400 mijë lekë SIFQ, sipas An dhjetor 2025, fondi nuk është detajuar në SIFQ.

3. Programi “ Mbështetja e Luftimit”

Në total për vitin 2025 kemi shtesë të buxhetit në shumën 1,664,790 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601 kemi shtesë fondi në shumën 558,338 mijë lekë.

Në artikullin 602 kemi shtesë fondi në shumën 359,818 mijë lekë.

Në artikullin 606 kemi pakësim fondi në shumën 12,721 mijë lekë.

Në artikullin 231 kemi shtesë fondi në shumën 759,355 mijë lekë.

4. Programi “ Arsimimi Ushtarak”

Në total për vitin 2025 kemi rritje të buxhetit në shumën 24,802 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601 kemi pakësim fondi në shumën 26,010 mijë lekë.

Në artikullin 602 kemi shtesë fondi në shumën 26,510 mijë lekë.

Në artikullin 606 kemi shtesë fondi në shumën 119,272 mijë lekë.

Në artikullin 231 kemi pakësim fondi në shumën 94,969 mijë lekë.

5. Programi “ Mbështetje për Shëndetësinë”

Në total për vitin 2025 kemi rritje të buxhetit në shumën 13,440 lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601 kemi shtesë fondi në shumën 214.000 lekë.

Në artikullin 602 kemi shtesë fondi në shumën 100,000 lekë.

Në artikullin 606,kemi shtesë fondi në shumën 2,440 lekë.

Në artikullin 231 kemi pakësim fondi në shumën -303,000 lekë.

6. Programi “ Mbështetje për Ushtarakët”

Në total për vitin 2025 kemi rritje të buxhetit në shumën 28,958 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar në artikullin buxhetor të mëposhtëm:

Në artikullin 604 kemi shtesë fondi në shumën 28,958 mijë lekë.

7. Programi “ Emergjencat Civile”

Në total për vitin 2025 kemi pakësim të buxhetit në shumën 1,463,141 mijë **lekë** në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm (përfshirë investimet kapitale me financim të huaj):

Në artikullin 600 dhe 601 kemi shtesë fondi në shumën 49,422 mijë lekë.

Në artikullin 602 kemi pakësim fondi në shumën 160,000 mijë lekë.

Në artikullin 604 kemi pakësim fondi në shumën 160,728 mijë lekë.

Në artikullin 605 kemi pakësim fondi në shumën 7,000 mijë lekë.

Në artikullin 606 kemi shtesë fondi në shumën 985 mijë lekë.

Në artikullin 231 investime të brendshme (01) kemi pakësim fondi në shumën 185,820 lekë.

Në artikullin 231 investime të huaja (02) kemi pakësim fondi në shumën 1,000,000 lekë, sipas An dhjetor 2025, fondi nuk është detajuar në SIFQ.

Investime e huaja në vlerën 1,012,050 mijë lekë nuk çelen në sistemin e thesarit SIFQ dhe ky fond përbën tavanin e investimeve të huaja, të cilat mund të përthithen nga programet buxhetore “Emergjencat Civile” dhe “Forcat e Luftimit” gjatë vitit ushtrimor.

Numri i rialokimeve të miratuara:

Deri në fund të vitit 2025, përveç shtesave që përmendëm dhe më sipër për çelje e fondit të veçantë, shtesë fondi me VKM, shtesë fondi si rezultat i rritjes së pagave, shtesë fondi në investime, shtesë buxheti me tri akte normative, si dhe kemi miratuar edhe transferimet që kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave që kanë paraqitur programet buxhetore.

Numri i punonjësve:

Numri total i punonjësve të miratuar me ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” është **8 854 punonjës**, sipas strukturave kryesore për programet është i detajuar si më poshtë:

Tabela nr. 6

Emërtimi i programit	Numri i punonjësve në plan	Numri i punonjësve në fund të vitit 2025		Numri i punonjësve në fakt		Ndeshimi i numrit të punonjësve (plan -fakt)
	Viti 2025	Nr.	% kundrejt nr. total	Nr.	% kundrejt nr. total	Nr.
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	378	398	4	333	4	65
Forcat e Luftimit	4,232	4,255	48	4,106	48	149
Mbështetja e Luftimit	3192	3,249	36	3,066	36	183
Arsimimi Ushtarak	375	375	4	343	4	32
Mbështetja për Shëndetësinë	481	481	5	468	6	13
Emergjencat Civile	196	196	2	173	2	23
TOTALI I MM	8,854	8,954	100	8,489	100	465

Siç vërehet nga tabela më sipër, në vitin 2025 Ministrisë së Mbrojtjes i është shtuar numri i personelit me 100 punonjës, referuar urdhrin të Kryeministrit nr. 44, datë 06.03.2025, “Për disa shtesa në urdhrin nr. 14, datë 15.02.2025, “Për miratimin e Strukturës Organizative të Forcave të Armatosura të RSH”.

Për programin “Forcat e Luftimit” që zë dhe përqindjen më të madhe të numrit të punonjësve, numri faktik mesatarisht në muaj për këtë periudhë është 4,106 punonjës dhe diferenca prej 149 punonjës parashikohet të plotësohet në vijim.

Për informacion përmbljedhës, lutemi referojuni Aneksit nr. 1: Raporti i përmbljedhës i shpenzimeve të ministrisë/institucioni buxhetor.

• PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI

Të gjitha programet buxhetore të Ministrisë, në respektim dhe promovim të plotë të barazisë gjinore, kanë përcaktuar tregues gjinorë konkretë të përshtatshëm dhe të matshëm në nivel qëllimi dhe objektiv. Gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet e Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor (Ministria e Financave), nga të gjithë programet buxhetore janë përfshirë edhe disa tregues kyç të performancës që lidhen me buxhetimin mbi bazë gjinore dhe vlerat e synuara për këta tregues janë pjesë e raporteve të monitorimit gjatë vitit 2025.

1. Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi”, ka përcaktuar tregues gjinorë në nivel qëllimi si më poshtë:

Qëllimi: Të kontribuojë në miradministrimin, menaxhimin efektiv të fondeve dhe përmbushjen e detyrimeve financiare për personelin e MM-së dhe SHPFA-së, Përfaqësitë Ushtarake, Shtabet e NATO-s, sipas detyrimeve ligjore të përfshirjes në iniciativat rajonale dhe organizatat ndërkombëtare”.

- Rekomandime të zbatuara të auditimeve të kryera;
- Raporti gra/burra për program;
- Gra të përfaqësuara në nivele drejtuese;
- Numri i grave të përfaqësuara në nivele drejtuese kundrejt numrit të burrave në të njëjtin pozicion.

Objektivi “Menaxhimi me eficiencë dhe efektivitet i burimeve njerëzore dhe financiare”:

Të gjithë këta tregues janë të matshëm në numër dhe në përqindje, dhe monitorohen mbi bazë vjetore.

2. Programi “Forcat e Luftimit” ka përcaktuar tregues gjinorë në nivel qëllimi, si më poshtë:

Qëllimi “Të kontribuojë në sigurimin e një force luftimi tokësore, detare dhe ajrore operationale të mirëstërvitur, profesionale e të ndërveprueshme me NATO-n.

Koordinimin e politikave për planifikimin dhe arritjen e rezultateve në përdorimin me efektivitet të fondeve, duke hartuar dhe zbatuar strategji për minimizimin e riskut.

Raporti gra/burra për program.

- Numri i grave në pozicionet drejtuese kundrejt numrit të burrave në të njëjtin pozicion

Objektivi “Menaxhimi me eficiencë dhe efektivitet i burimeve njerëzore dhe financiare”:

Të gjithë këto tregues janë të matshëm në numër dhe në përqindje, dhe monitorohen mbi bazë vjetore.

3. Programi “Mbështetja e Luftimit”

Qëllimi i këtij programi është: “Mbështetja me logjistikë, inteligjencë strategjike, shërbimet operationale të mbrojtjes civile, në luftën kundër korrupsionit në Forcat e Armatosura, për siguri dhe stabilitet:

- Niveli i mbështetjes me shërbime për FA-në;
- Niveli i mbështetjes operationale për FA-në;
- Gra në drejtim dhe gra të trajnuara në FA.

Objektivi: “Sigurimi i sistemeve të armatimit, teknikës, pajisjeve të avancuara për të gjitha strukturat e parashikuara për angazhime në operationet e NATO-s, BE-së, OKB-së etj.”

- Treguesit e performancës për këtë objektivi:
- Përqindja e furnizimit në kohë dhe mbështetja logjistike e FA-së;
- Menaxhimi në kohë dhe profesional i operationeve të EC-së dhe CIMIC.

4. Programi “Arsimimi Ushtarak”

Qëllimi i këtij programi është: “Arsimimi, trajnimi, stërvitja dhe përgatitja e personelit ushtarak dhe civil të FA-së, për të përmbushur detyrimin kushtetues të sigurimit të pavarësisë së vendit, pjesëmarrje aktive në misionet ushtarake të NATO-s, si dhe në përballimin e emergjencave civile”.

Tregues performance: Ushtarakë të aftë e të përgatitur për të përballuar me sukses misionet në kuadër të NATO-s, OKB-së, BE-së etj.

- Personel i aftë i angazhuar në përballimin e emergjencave civile;
- Ushtarakë profesionistë të aftë për mbrojtjen territoriale dhe pavarësisë së vendit etj.

Objektivi: Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil, nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse në përputhje me standardet e NATO-s”.

Tregues të performancës:

- Numër personeli i trajnuar;
- Numër personeli i stërvitur;
- Numër ushtarakësh të rinj të trajnuar dhe pranuar kundrejt numrit të aplikimeve;
- Numër personeli që përfundojnë trajnimet dhe kalojnë testet;
- Numër manualesh të botuara kundrejt planifikimit;
- Numër kërkimesh shkencore të publikuara kundrejt planifikimit;
- Numër studimesh të zhvilluara për standardizimin e FA-së;
- Numër personeli ushtarak të gjinisë femra të pranuar në FA.

Të gjithë këta tregues janë të matshëm në numër dhe në përqindje dhe monitorohen kryesisht mbi bazë vjetore.

Për informacion më të hollësishëm, lutemi referojuni Aneksit nr. 4: Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit ku janë përfshirë edhe treguesit me bazë gjinore.

5. Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”

Qëllimi kryesor: “Shërbim shëndetësor të specializuar mjekësor dhe spitalor në nivel universitar në trajtimin në rang kombëtar të politraumave”, Tregues i performancës:

- Numri i shtrimeve reanimatore;
- Numri total i operacioneve sipas specialiteteve;
- Numri i ekzaminimeve imazherike;
- Numri i ekzaminime laboratorike;
- Numri i vizitave ambulatorie në poliklinikë,
- Numri i ditëve të qëndrimit mesatar në spital;
- Numri i urgjencave të kirurgjisë dhe terapisë;
- Numri i pacientëve të shtruar të planifikuar dhe urgjente në SUT;
- Numri i operacioneve të planifikuara dhe urgjente për çdo sallë operacioni.

Të gjithë këta tregues janë të matshëm në numër dhe në përqindje dhe monitorohen kryesisht mbi bazë vjetore.

6. Programi “Mbështetje për Ushtarakët”

Qëllimi kryesor: Sigurimin dhe mbështetjen financiare e ushtarakëve në rezervë dhe në lirim, trajtim të veçantë të ushtarakëve të nëndetëseve në pension dhe pilotëve fluturues në pension. Përcaktimi, vlerësimi dhe planifikimi i përfitueseve sipas këtyre kategorive dhe tregues performance:

Përqindja e mbështetjes financiare të ushtarakëve në rezervë dhe në lirim.

Objektivi: Trajtim të veçantë të ushtarakëve, ushtarakëve të nëndetëseve në pension dhe pilotëve fluturues në pension, tregues i performancës:

-Numër përfituesish ushtarakë.

Të gjithë këta tregues janë të matshëm në numër dhe në përqindje dhe monitorohen kryesisht mbi bazë vjetore.

7. Programi “Emergjencat Civile” ka përcaktuar tregues gjinorë në nivel qëllimi si më poshtë:

Qëllimi: “Mbrojtja e jetës së shtetasve, pronës së tyre, gjësë së gjallë, mjedisit, objekteve social-kulturore dhe të rëndësishme të veçantë, objekteve të trashëgimisë kulturore, infrastrukturës kritike etj., nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësi që shkaktohen nga veprimtari njerëzore, duke koordinuar veprimet e strukturave operacionale që kanë përgjegjësi në fushën e emergjencave civile”.

Objektivi: Zvogëlimi i humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis.

- Numër ndërhyrjesh të ofruara në rast tërmeti;
- Numër ndërhyrjesh të ofruara në rast përmytje;
- Numër ndërhyrjesh të ofruara në rast zjarri.

Objektivi: “Rritja e stokut në mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore”.

- Rritja e stokut të mallrave rezervë shteti të cilat do të përdoren për t’i ardhur në ndihmë familjeve të prekura nga fatkeqësitë natyrore me mallra rezervë shtetërore.

Të gjithë këta tregues janë të matshëm në numër dhe në përqindje dhe monitorohen kryesisht mbi bazë vjetore.

• PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

1. Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 4.2% të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 99 %.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 99 %, nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 98 %;
- Shpenzime të tjera, në masën 95%,

Shpenzime Kapitale total, realizimi është në masën 69%.

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i Brendshëm, realizimi është në masën 69%.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve.

Janë parashikuar 1 produkt dhe 8 projekte investimi me vlerë 1,673,933 mijë lekë dhe është realizuar 1 produkt dhe 5 projekte investimi me vlerë 1,656,803 mijë lekë ose 99 %, të cilat paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 7

Nr.	Emërtimi	Përqindja e realizimit
	Totali i Shpenzimeve Korrente	99
1.	Akte ligjore e nenligjore te pergatitura	99
	Totali i Shpenzimeve për Investime	100
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	100
1.	Blerje pajisjesh për Zonimin TEMPEST të ambienteve, godinave dhe mburojave.	100
2.	Përmirësim në hardware/software dhe ndërtime të dhomave të serverave (NJUSK).	100
3.	Blerje pajisje Tik për MM-në dhe FA-në.	100
4.	Instalim i sistemeve kundër zjarrit.	100
5.	Blerje automjete për Përfaqësinë Ushtarake.	100

Shpenzimet e programit për investime.

Shpenzimet e programit për investime (financim i brendshëm),

Nga 8 projekte të parashikuara për investime, duke përfshirë edhe rialokimet gjatë vitit janë realizuar 5 projekte Realizimi faktik është në vlerën **77,654** mijë lekë ose 100 %.

Analitikisht tabela e projekteve të investimeve të programit i bashkëlidhet këtij relacioni.

Trajtimi i çështjes së barazisë gjinore.

Nga programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” janë përcaktuar tregues konkretë të përshtatshëm dhe të matshëm, të cilët janë identifikuar, produktet me kostot përkatëse që kontribuojnë në realizimin e tyre.

2. Programi “Forcat e Luftimit”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 54.6% të buxhetit, përfshirë këtu investimet me financim të huaj (ose 44 % të buxhetit, pa përfshirë investimet me financim të huaj) të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 96 %.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 99 %, nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 100 %,

- Shpenzime të tjera, në masën 98 %,

Shpenzime Kapitale total, realizimi është në masën 93%, nga të cilat:

- Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm, realizimi është në masën 93%,
- Shpenzime Kapitale me financim të huaj, realizimi është në shumën 0 %.

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i Brendshëm, realizimi është në masën 93%.
- Financimi i Huaj, realizimi është në shumën 0 lekë.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve.

Janë parashikuar 4 produkte me vlerë 9,238,135 mijë lekë dhe janë realizuar 4 produkte me vlerë 9,155,672 mijë lekë ose 99 %, të cilat paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 8

Nr.	Emërtimi	Përqindja e realizimit
	Totali i Shpenzimeve Korrente	99.1
1.	Forca Tokësore në gatishmëri dhe operacione.	99.6
2.	Kontingjente ushtarake në misione paqeruajtëse.	100
3.	Forca Detare në gatishmëri dhe operacione.	99.3
4.	Forca Ajrore në gatishmëri dhe operacione.	97
	Totali i Shpenzimeve për Investime	51
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm	93
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me Financim të Huaj	9
1.	Ndërtim objektësh dhe punime për rikonstruksione të godinave të KFT Zall- Herr.	73.2
2.	Armatim i lehtë, municione dhe aksesore, makineri e pajisje.	94.9
3.	Ndërtim i rrjetit inxhinierik i poligonit Kombëtar Pajet/Ndërtim infrastrukturor i rajonit stërvitor Pajet.	100
4.	Blerje pajisje kompjuterike / IT për kompletimin e strukturave të FT-së.	0
5.	Kompletim i sallave operacionale dhe ndërtesave të FT-së me orendi dhe pajisje (Faza e dytë e kompletimit).	100
6.	TVSH	20
7.	Krijimi i kapitalit fillstar KAYO.	100
8.	Blerje dronësh (Financim KAYO).	100
9.	Sisteme Nënujore Autonome për kërkimin e minave detare për operacionet VSËMCM (Autonomous underwater vehicle) dhe pajisje për identifikimin dhe klasifikimin e minave detare, Sonar scanner.	95
10.	Mjet i telekomanduar nënujor (Remote Operation Vehicle).	Pakësuar me AN
11.	Rinovimi teknologjik i radarëve të lundrimit në anije.	Pakësuar me AN
12.	Punime infrastrukturore në Porto Palermo (tunel, bankina etj.)	Pakësuar me AN
13.	Ndërtim dhe rikonstruksion objektësh (Godina shumëfunktionale e QZH-së, Shkolla e Trupës, Grupi i bordingut etj.), bankinash, tuneli dhe thellim bazeni Pashaliman.	Pakësuar me AN
14.	Platforma e grumbullimit dhe përpunimit të informacionit detar.	Pakësuar me AN
15.	Rinovimi, përmirësimi teknologjik i sistemit SIVHD, pajisje me kamera vëzhgimi infra të kuqe dhe ruajtje të integruara me sistemin SIVHD mirëmbajtje afatmesme SIVHD.	Pakësuar me AN

16.	Dylbi profesionale optike dhe për shikimin natën për repartet e Forcës Detare	100
17.	Ndërtimi i mureve përforcuese të Komandës së Kepit të Palit (prona nr.240, godina nr. 34), dhe rikonstruksion i pjesshëm i godinës. Rikonstruksion i objektit 2-katësh në Kepin e Palit.	Pakësuar me AN
18.	Rrethimi i jashtëm nr. 245 (Kompania e Mbështetjes, QVD, QNOD (ish-KFD))	0
19.	Ndërtim i Portit të Ri në Porto – Romano.	Pakësuar me AN
20.	Rikonstruksion i godinës nr.1 të KFD (Përmirësimi i sistemit të ajrim kondicionimit dhe hidroizolimit, sistemi rrufepritës).	Pakësuar me AN
21.	Ndërtim godine për PSV Maja e Thanasit (Prona nr.1273).	Pakësuar me AN
22.	Rikonstruksion i dhomës së re të serverave të SIHVD (Serverat do të transferohen në dhomë tjetër të përshtatshme) prona nr.245	Pakësuar me AN
23.	Pajisje për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe shërbimit në reparte, pajisje kuzhinë, frigorifer, lavatriçe, soba, televizorë etj.	Pakësuar me AN
24.	Kompletimi me kapacitet të zbulimit dhe neutralizimit të objekteve pa pilot (C-UAS) në nivel kombëtar.	Pakësuar me AN
25.	Rikonstruksion i Shtëpisë së Ushtarakëve Kuçovë.	87.2
26.	Ndërtimi i perimetrit të sigurisë Baza Ajrore Kuçovë, (ndërtim gardhi rrethues dhe rrugëve lidhëse).	0
27.	Ndërtim infrastrukturor Baza Ajrore Kuçovë.	75.6
28.	Shpronësim tokash në Kuçovë.	19.1
29.	Transponderi Ushtarak Mod 5 IFF.	Pakësuar me AN
30.	Qendra për stërvitjen e kandidatëve të rinj Gjadër.	Pakësuar me AN
31.	Qendra e Kontroll-Raportimit.	Pakësuar me AN
32.	Hangarë, mjedise për mirëmbajtjen, riparimin dhe testim, in UAV	97.8
33.	Hangarë për helikopterët Blackhawk.	92
34.	Sistemi i mbrojtjes ajrore bazuar në tokë (GBAD, MRAD/SHORAD).	Pakësuar me AN
35.	Sisteme komunikimi dhe informacioni Baza Ajrore e NATO-s Kuçovë (CIS).	Pakësuar me AN
36.	Sistemi i integruar i vëzhgimit të hapësirës ajrore.	97.5
37.	Ngjitja e Shkollës së Aviacionit Vlorë.	100
38.	Ndërtim i rrjeteve inxhinierike dhe TAXIWAY Farkë.	Pakësuar me AN
39.	Ndërtim i hangarëve në Shkollën e Aviacionit.	Pakësuar me AN
40.	Kompletimi i sallave operacionale, ndërtesave të Forcës Ajrore me orendi dhe pajisje.	99.3
41.	Ndërtim i sistemit antidron C-UAS.	100
42.	Blerje e avionëve me krahë FIX shumërolësh.	Pakësuar me AN
43.	Ndërtim i sistemit të radio-komunikimit digjital në FA.	0
44.	Kapacitete të ofruara në modernizim.	0

Shpenzimet e programit për investime.

Shpenzimet e programit për investime (financim i brendshëm + financim i huaj).

Në shpenzimet për investime janë buxhetuar gjithsej 44 projekte nga të cilat 42 projekte me investime të brendshme dhe 2 projekte investim me financim të huaja të parashikuara, duke përfshirë edhe rialokimet gjatë vitit. Janë pakësuar me akt normativ për ndryshime në buxhetin e vitit ushtrimor, gjithsej 21 projekte investimi dhe janë realizur 18 projekte në vlerën 8,225,629 mijë lekë ose 93%.

Trajtimi i çështjes së barazisë gjinore.

Nga programi “Forcat e Luftimit ” janë përcaktuar tregues konkretë të përshtatshëm dhe të matshëm të cilët janë identifikuar gjatë vitit 2025.

3. Programi “Mbështetja e Luftimit”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 24.4% të buxhetit me ndryshime të miratuar për MM-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 97%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 99 %, nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 100 %;
- Shpenzime të tjera, në masën 98 %.

Shpenzime Kapitale total, realizimi është në masën 89%, nga të cilat:

- Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm, realizimi është në masën 89%.
-

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve.

Janë parashikuar 13 produkte me vlerë 7,660,371 mijë lekë dhe janë realizuar 13 produkte 7,559,558 mijë lekë dhe janë planifikuar 49 projekte investimesh me vlerë 2,317,855 mijë lekë dhe realizuar 26 projekte investimesh në vlerë 2,069,971 mijë lekë, të cilat paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 9

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Përqindja e realizimit
	Totali i Shpenzimeve Korrente	99
1.	Kapacitete Operacionale që sigurojnë mbështetjen logjistike të FARSH-it.	99
2.	Qendra e Kulturës funksionale.	99
3.	Arkiva funksionale.	98
4.	Personel i rekrutuar dhe dosje të administruara për trajtim financiar.	98
5.	Sistem i Automatizuar Logjistik i Menaxhuar.	96
6.	Licenca import/eksportit të dhëna.	97
7.	Harta ushtarake të prodhuara.	97
8.	Inteligjenca ushtarake për autoritet e drejtimit dhe komandimit të FA-së.	98
9.	Hapësira detare e monitoruar.	97
10.	Polici ushtarake funksionale.	100
11.	Sistem funksional kontrolli për FA-në.	93
12.	Objekte në ruajtje dhe godina pushimi të ofruara.	99
13.	Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë.	98
	Totali i Shpenzimeve për Investime	89
	Nëntotali i Shpenzimeve Kapitale me Financim të Brendshëm	89
	Nëntotali i Shpenzimeve Kapitale me Financim të Huaj	0
1.	Mjete transporti dhe speciale FA	100
2.	Zhvillimi i kapaciteteve O1001, K1002, S1003, S1004, L1005, N1006, N1007.	76
3.	Ngritja e sistemit të informacionit për gjeografinë dhe infrastrukturën.	0
4.	Kompletimi i ambienteve për Zyrat e Rekrutimit në rrethe.	58
5.	Abonimi dhe suport teknik vjetor për setin e programe Teledzne Cartis.	0

6.	Abonimi dhe suporti teknik vjetor për programin SevenCs.	0
7.	Kondicioner zyresh 9-btu.	86
8.	Blerje, pajisje kompjuterike dhe kancelarike.	0
9.	Zhvillimi i kapaciteteve Ç1009; M1019; P1020; S1021; P1022; P1023;T1012.	0
10.	Blerje automjeti transporti për personelin e QISM-it.	96
11.	Ndërtim objekti shumëfunktional për akomodimin e Komandës, Shtabit	96
12.	Rikonstruksion tërësor i ndërtesës së Komandës dhe Shtabit të Batalionit.	100
13.	Ndërtim grup-depo për administrimin e pajisjeve.	94
14.	Rikonstruksion depush, godina 1-katëshe, truproje, rrethim pjesor.	95
15.	Rikonstruksion i objektit Qendra ePersonel-Rekrutimit, Godina nr.35.	100
16.	Ndërtimin e sistemit të Telefonise VoIP & VTC në FA(Radiorele Digitale) +	85
17.	Ndërtimi i sistemit të trasmetimit shumëkanalësh me vale FD.	100
18.	Blerje e pajisjeve similitore.	99
19.	Kompjuter desktop QNOD.	96
20.	Blerje pajisje për përmirësimin e Kapaciteteve Operacionale	0
21.	Blerje e kompjuterave Laptop profesionale për stafin e QISM-it.	0
22.	Karrige zyresh me mbështetje (QNOD).	84
23.	Kompletimi me Smart Bord të Klasave të KMS (Tabela interaktive min 86").	0
24.	Blerje pajisjesh për TIK (Teknologjinë dhe Informacionin KMS).	0
25.	Rikonstruksion i godinave të dëmtuara nga tërmeti prona 231 në SHPU.	93
26.	Pajisje hotelerie për SHPU Jalë, Durrës, Pogradec dhe Vlorë.	100
27.	Sistemi i infrastrukturës + Postobloku nr. 4 + Drenazhim i fushës së futbollit.	95
28.	Pajisje me elementet e sistemit të sigurisë elektronike në Rep. Usht. nr. 6630.	0
29.	Ndërtim objekti i përkohshëm (Element i mbështetjes kombëtare në film city, Prishtinë).	100
30.	Studime e projektme (Art.230).	93
31.	Kompletimi me pajisje e orendi (tavolina, karrige, raftet etj.) për FA-në.	99
32.	Blerje pajisje për sistemin BICES.	0
33.	Bateri UPS 1000VA AKSHE.	94
34.	Blerje droni.	0
35.	Blerje e licencave për përmirësimin dhe përditësimin e Sistemeve të Mbrojtjes Kibernetike për Forcat e Armatosura.	0
36.	Godine 2k (Mbulim me çati, rikonstruksion i nyjave dhe higjienës sanitare	0
	TVSH (Detyrim për projektet e KM-së)	73
SHUMA TOTALE E INVESTIMEVE		2,069,971

Shpenzimet e programit për investime.

Shpenzimet e programit për investime (financim i brendshëm).

Nga 36 projekte të parashikuara për investime, duke përfshirë edhe rialokimet gjatë vitit janë realizuar 24 projekte. Realizimi faktik është në vlerën 2,069,971 mijë lekë ose 89% kundrejt buxhetit të planifikuar për investime për vitin 2025, në të cilën është përfshirë dhe likuidimi i detyrimit për TVSH-në në vlerën 7,294 mijë lekë, realizimi i projekteve sipas njësive shpenzuese paraqitet më poshtë:

- **Komanda Mbështetëse**, nga 7 projekte të planifikuara ka realizuar 7 projekte në vlerën 1,442,177 mijë lekë (përfshirë dhe detyrimi për TVSH në vlerën 7,294 mijë lekë), tri projekte investimi vazhdojnë dhe në vitin 2026.
- **Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake** nga 6 projekte të planifikuara, realizoi 1 projekt në shumën 126,768 mijë lekë, 5 projekte dështuan si pasojë e dështimit të procedurave të prokurimit.
- **Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes** nga 2 projekte të planifikuara, ka realizuar 1 projekt në vlerën 209,960 mijë lekë, i cili vijon dhe në vitin 2026.

- **Komanda Kibernetike e Ndërlidhjes** nga 5 projekte të planifikuara, ka realizuar 2 projekte në vlerën 11,771 mijë lekë, ndërsa 3 dështuan si pasojë e mos realizimit të procedurave të prokurimit.
- **Batalioni i Mbështetjes** nga 4 projekte të planifikuara, realizoi 3 projekte në masën 98% në vlerën 169,252 mijë lekë, ndërsa 1 dështoi si pasojë e mosrealizimit të procedurave të prokurimit.
- **Qendra e Personel-Rekrutimit** nga 3 projekte të planifikuara, realizoi 2 projekte në masën 100%, në vlerë 103,901 mijë lekë dhe 1 në masën 58%, projekt i cili për pjesën e mbetur vijon në vitin 2026.
- **Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare** nga 3 projekte të parashikuara, realizoi të 3 projekte në masën 95 % në vlerë 1,951 mijë lekë.
- **Qendra e Inovacionit të Sigurisë së Mbrojtjes** nga 2 projekte të parashikuar, realizoi 1 projekt në masën 99 % në vlerë 3,958 mijë lekë, ndërsa 1 dështoi si pasojë e mos realizimit të procedurave të prokurimit.
- **Koleji i Mbrojtjes dhe Sigurisë** nga 2 projekte të planifikuara nuk realizoi asnjë projekt për vitin 2025, si pasojë e dështimit të procedurave të prokurimit.
- **Qendra e Menaxhimit të Materialeve** planifikoi 1 projekt për vitin 2025. Si pasojë e vonesave në procesin e prokurimit për këtë projekt kontrata u nënshkrua me vonesë dhe realizimi i tij dështoi për vitin 2025. Ky projekt do të finalizohet gjatë vitit 2026.
- **Agjencia e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve** planifikoi 1 projekt për vitin 2025, i cili u realizuar në masën 39 % në shumën 358 mijë lekë.

Analitikisht tabela e projekteve të investimeve të programit i bashkëlidhet këtij relacioni.

4. Programi “Arsimimi Ushtarak”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 3.4% të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 92%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 96 %, nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 96 %;
- Shpenzime të tjera, në masën 95%.

Shpenzime Kapitale total, realizimi është në masën 86%, nga të cilat:

- Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm, realizimi është në masën 86%.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve.

Janë parashikuar 1 produkt dhe 7 projekte me vlerë 1,451,802 mijë lekë dhe janë realizuar 1 produkt dhe 5 projekte me vlerë 1,342,871 mijë lekë ose 92 %, të cilat paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 10

Nr.	Emërtimi	Përqindja e realizimit
		92%
	Totali i Shpenzimeve Korrente	96
1.	Kapacitete të afta për trajnimin dhe arsimimin cilësor në Forcat e Armatosura.	96%
	Totali i Shpenzimeve për Investime	86
	Nëntotali i Shpenzimeve Kapitale me Financim të Brendshëm	86
1.	Ndërtimi i godinës së re të AFA (Prona.21).	88
2.	Blerje licenca VBS3 dhe 15 laptopë për VBS3 (MTT).	100
3.	Arredimi i ambienteve të brendshme të godinave (fakultet dhe Mensë-Kuzhinë të Kampusit të Ri të AFA-së)	82
4.	Kompletimi me pajisje informatike dhe teknologjike të dy godinave të masterplanit (fakultetit dhe mensës) TIK.	0
5.	Pasurimi me literaturë të bibliotekës së AFA-së.	0
6.	Ndërtim i kabinës elektrike - Masterplan AFA.	100
7.	Veshje me sistem kapot për objektet e QAPU-së, Bunavi – Vlorë.	100

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për vitin 2025, pa përfshirë kapitullin 06, paraqitet në shumën 1,342,871 mijë lekë ose 92 %.

Shpenzimet e programit për investime.

Nga 7 projekte të parashikuara për investime (financim i brendshëm, duke përfshirë edhe rialokimet gjatë vitit janë realizuar 5 projekte, realizimi faktik i të cilave është në vlerën 396,905 mijë lekë ose 86%. Ky nivel realizimi është si rezultat i mosrealizimit procedurave të prokurimit.

5.Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 4.8% të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 99%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 99 %, nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 98 %;
- Shpenzime të tjera, në masën 99 %,

Shpenzime Kapitale total, realizimi është në masën 98%, nga të cilat:

- Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm, realizimi është në masën 98%

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve.

Janë parashikuar 1 produkt dhe dy projekte me vlerë 1,906,000 mijë lekë, është rishikuar gjatë vitit buxheti në vlerë 1,919,440 mijë lekë dhe janë realizuar në total 1 produkt dhe dy projekte me vlerë 1,902,997 mijë lekë ose 99 %, të cilat paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 11

Nr.	Emërtimi	Përqindja e realizimit
	Totali i Shpenzimeve Korrente	
		99
1.	Pacientë të trajtuar ambulator dhe të shtruar të urgjencës.	99
	Totali i Shpenzimeve për Investime	
		98
	Nëntotali i Shpenzimeve Kapitale me financim të brendshëm	
		98
1.	Rikonstruksion godinash.	100
2.	Blerje aparaturash dhe pajisje mjekësore.	94

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për vitin 2025, pa përfshirë kapitullin 06, paraqitet në shumën **1,902,997** mijë lekë ose 99 %.

Shpenzimet e programit për investime

Shpenzimet e programit për investime (financim i brendshëm),

Nga 2 projekte të parashikuara për investime, duke përfshirë edhe rialokimet gjatë vitit janë realizuar 2 projekte, realizimi faktik i të cilave është në vlerën 193,285 mijë lekë ose 98%.

6. Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 13.2% të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 100%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 100 %, nga të cilat:

- Shpenzime për Transferata Korrente të Brendshme, në masën 100 %.

Janë parashikuar **5 produkte** me vlerë **5,228,985** mijë lekë dhe janë realizuar **5 produkte** me vlerë **5,228,985** mijë lekë ose 100 %, të cilat paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 12

Nr.	Emërtimi	Përqindja e realizimit
	Totali i Shpenzimeve Korrente	
		100
1.	Sigurimi suplementar i ish-ushtarakëve dhe ish-policëve.	100%
2.	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë të pilotëve fluturues në pension.	100%
3.	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë të punonjësve të industrisë ushtarake.	100%
4.	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë të ushtarakëve të nëndetëseve në pension.	100%
5.	Kontributet e buxhetit të shtetit në bazë të legjislacionit për financimin e ushtarakëve në pension të parakohshëm.	100%

Realizimi i shpenzimeve korrente për programin për vitin 2025, paraqitet në shumën **5,228,985** mijë lekë ose 100 %.

7. Programi "Emergjencat Civile"

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 6.1% të buxhetit me ndryshime të miratuar për MM-në për periudhën raportuese.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 80%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 92%, nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 98%;
- Shpenzime të tjera, në masën 90%.

Shpenzime Kapitale total, realizimi është në masën 73%, nga të cilat:

- Shpenzime Kapitale me financim të Brendshëm, realizimi është në masën 73 %;
- Shpenzime Kapitale me Financim të Huaj, realizimi është në shumën 0 %.

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i Brendshëm, realizimi është në shumën 1,327,226 mijë lekë ose 73%.
- Financimi i Huaj, realizimi është në 0 mijë lekë ose 0%.
- Pagesë TVSH-je dhe taksa doganore, realizimi është në 51 337 mijë lekë.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve:

Janë parashikuar 5 produkte dhe 18 projekte investimi me financim të brendshëm, janë realizuar 13 projekte. Realizimi i produkteve është 1,073,091 mijë lekë ose 92%, realizimi i projekteve në total është 1,327,226 mijë lekë ose 73%. Në formë të detajuar informacioni paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 13

Nr.	Emërtimi	Përqindja e realizimit	
	Totali i Shpenzimeve Korrente	92%	
	Kodi i produktit	Emërtimi	
1.	91707AA	Mbrojtja e jetës njerëzore, pronës, trashëgimisë kulturore.	89%
2.	91707AB	Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësitë.	98%
3.	91707AD	Stoku mallra ushqimore (rezervë materiale shtetërore).	83%
4.	91707AE	Stoku mallra industriale (rezervë materiale shtetërore).	99%
5.	91707AG	Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese dhe mbrojtëse.	80%
	Totali i Shpenzime për Investime	73%	
	Kodi i produktit	Emërtimi	
1.	18AZ901	Fatkeqësi natyrore të menaxhuara.	95%
2.	18AZ904	Digat.	75%
3.	18AZ905	Parandalimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore.	74%

4.	18BA101	Blerje pajisje kompjuterike dhe fotokopje.	0%
5.	18BA105	Çadra strehimi.	100%
6.	20AD002	Blerje mjete speciale për AKMC-në.	89%
7.	20AD106	Robot nënujor për AKMC-në.	0%
8.	21AD301	Ushqim për bagëti.	28%
9.	21AD501	Ndërtim i stacioneve hidrometeorologjike.	100%
10.	21AD502	Investime të Bashkive për Mbrojtjen Civile (sipas VKM 414, datë 08.07.2021).	16%
11.	22AG103	Bashkëfinancim me projektet e huaja Flood North Albania.	100%
12.	22AG104	Bashkëfinancim me projektet e huaja Local Drm.	100%
13.	22AG105	Bashkëfinancim me projektet e huaja Sa Resilience.	61%
14.	24AK001	Bashkëfinancim me projektin e huaj EMERGE.	0%
15.	25AD701	Bashkëfinancim AKMC për ALBADAPT/EAR-MHES	100%
16.	M170312	Blerje pajisje zyre dhe kompjuterike.	71%
17.	M170521	Mallra Rezervë Shteti Ushqimore.	98%
18.	M170528	Mallra rezervë shteti industrial.	83%
	M170411	Pagesë TVSH.	80%
	Kodi i produktit	Emërtimi	
1.	19AC501	Realizimi i blerjes së dy SOFTWARE-ve dhe pajisje për dhomën e monitorimit	100
2.	22AG202	FIRE PREP	100
3.	22AG203	ROSES	100
4.	22AG204	Financim i huaj	0
5.	22AG205	Flood North Albania	47
6.	22AG206	Local DRM	17
7.	22AG207	Sa Resilience	28
8.	24AK101	EMERGE	0
9.	25AD801	Grant Albadapt/EAR-MHEWS	13
		Nëntotali i Shpenzimeve Kapitale me Financim të Huaj	5
		Nëntotali i Shpenzimeve Kapitale me Financim të Brendshëm	73%

Projektet me financim të huaj

Investimet e huaja, të cilat janë evidentuar në këtë monitorim, kanë të bëjnë me fondet e AKMC-së në kapitull 02. Këto fonde edhe pse janë pjesë e buxhetit të programit “Emergjencat Civile”, këto projekte nuk kanë plan të miratuar dhe nuk raportohen nëpërmjet sistemit të thesarit.

Këtë vit AKMC-ja ka në zbatim 2 projekte, përkatësisht EMERGE dhe Grant Albadapt/EAR-MHEWS (për të cilin është ngritur një strukturë e posaçme PIU, me kod institucioni 1017901).

Realizimi i shprehur në monitorim përfaqëson vlerën e shpenzimeve të realizuara gjatë periudhës 12-mujore në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë fonde të akorduara nga donatorët dhe përdoren në përputhje me kontratat e lidhura sipas aktiviteteve të përcaktuara në Grant Agreement.

Në zbatim të udhëzimit nr. 10 datë 12.07.2024, “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, lëvizjet e këtyre llogarive raportohen pranë Ministrisë së Financave dhe hidhen prej tyre në systemin AFMIS.

2. Performanca jofinanciare e programit buxhetor.

1. Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”

Qëllimi i këtij programi është: Të kontribuojë në miradministrimin, menaxhimin efektiv të fondeve dhe përmbushjen e detyrimeve financiare për personelin e MM-së dhe SHPFA-së, Përfaqësitë Ushtarake, Shtabet e NATO-s, sipas detyrimeve ligjore të përfshirjes në iniciativat rajonale dhe organizatat ndërkombëtare, duke bërë të mundur koordinimin e politikave për planifikimin dhe arritjen e rezultateve në përdorimin me efektivitet të fondeve, duke hartuar dhe zbatuar strategji sektoriale në përputhje me standardet e NATO-s.

Për këtë program janë parashikuar objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre. Për vitin 2025 objektivat kryesore janë:

- Menaxhimi me eficiencë dhe efektivitet i burimeve njerëzore dhe financiare.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Politika dhe/ose strategji sektoriale të miratuara në përputhje me standardet e NATO;
- Përqindja e punonjësve të trajnuar kundrejt totalit;
- Numri i raporteve vlerësimi të kryera;
- Numri i akteve ligjore e nënligjore të përgatitura kundrejt planifikimit;
- Numri i auditimeve të kryera kundrejt planifikimit;
- Numri i proceseve rekrutimi të kryera;
- Numri i marrëveshjeve të realizuara kundrejt planifikimit.

Performanca e treguesve sa më sipër matet me bazë vjetore.

2. Programi “Forcat e Luftimit”

Qëllimi i këtij programi është: Për një forcë luftimi operacionale, të mirë stërvitur, profesionale edhe në përputhshmëri me standardet e NATO-s.

Programi “Forcat e Luftimit” përmban 3 nënprograme: **Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare dhe Komanda e Forcës Ajrore.** Për secilin nga këto nënprograme janë parashikuar objektiva specifike.

Objektivat kryesorë janë:

Objektivi 1: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve operacionale të Forcës Tokësore.

- **Treguesit e performancës për këtë objektiv:**
- Niveli i kompletimit me personel;
- Niveli i kompletimit me personel;
- Niveli i trajnimit;
- Përqindja e grave në forcat tokësore.

Objektivi 2: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve operacionale të Forcës Detare.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Kapacitete operacionale për Flotiljen Detare;
- Kapacitete operacionale për Qendrën e Vëzhgimit;
- Kapacitete operacionale për Shërbimin Hidrografik Shqiptar;
- Përqindja e grave në forcat detare.

Objektivi 3: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve operacionale të Forcës Ajrore.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Plotësimi me personel, pajisje, trajnime, stërvitje e resurse të BAJ Farkë/nivel 2;
- Plotësimi me personel, pajisje, trajnime, stërvitje e resurse të QKR-së.

Performanca e treguesve sa më sipër matet me bazë vjetore.

3. Programi “Mbështetja e Luftimit”

Qëllimi i këtij programi është: “Të sigurojë logjistikën e nevojshme, si dhe mbështetjen në operacione humanitare e misione ndërkombëtare, sigurimin e inteligjencës strategjike të nevojshme dhe sipas standardeve të NATO-s për siguri dhe stabilitet, sigurimin dhe mbështetjen e sistemeve të teknologjisë brenda standardeve të NATO-s, rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak dhe civil:

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Niveli i mbështetjes me shërbime për FA-Në;
- Përqindja e furnizimit në kohë dhe mbështetja logjistike e FA-së;
- Menaxhimi në kohë dhe profesional i operacioneve të EC-së dhe CIMIC;
- Niveli i mbështetjes operacionale për FA-në;
- Përqindja e grave të trajnuara në FA;
- Gra në nivele drejtuese në strukturat e FARSH-it;

- Mbështetja me logjistikë, inteligjencë strategjike, shërbimet operacionale të mbrojtjes civile, në luftën kundër korrupsionit në Forcat e Armatosura, për siguri dhe stabilitet;
- Pajisja me licencë importi/eksporti për mallrat ushtarake dhe mallra me përdorim të dyfishtë, si dhe lëndë plasëse;
- Sigurimi me sisteme komunikimi dhe informacioni (Radiokomunikim, Telekomunikacion, rrjete kompjuterike, VTC, BUE, PDSHD) në mbështetje të kërkesave të komandim-kontrollit të Forcave të Armatosura në nivelin strategjik, operacional dhe taktik në kohë paqe, krize dhe lufte.
Menaxhimi i Sistemit të Integruar të Automatizimit të Burimeve të Mbrojtjes në FA.

Të gjithë këta tregues janë të matshëm në numër dhe në përqindje dhe monitorohen kryesisht mbi bazë vjetore.

4. Programi “Arsimimi Ushtarak”

Qëllimi i këtij programi është: Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil, nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me standardet e NATO-s.

Objektivi kryesor i këtij programi është:

Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse në përputhje me standardet e NATO-s.

Treguesit e performancës për këtë objektivi:

- Numër personeli i trajnuar;
- Numër personeli i stërvitur;
- Numër ushtarakësh të rinj të trajnuar dhe pranuar kundrejt numrit të aplikimeve;
- Numër personeli që përfundojnë trajnimet dhe kalojnë testet;
- Numër manualesh të botuara kundrejt planifikimit;
- Numër kërkimesh shkencore të publikuara kundrejt planifikimit;
- Numër studimesh të zhvilluara për standardizimin e FA-së;
- Numër personeli ushtarak të gjinisë femra të pranuar në FA.
- Gra në nivele drejtuese në strukturat e AFA-së.

Të gjithë këta tregues janë të matshëm në numër dhe në përqindje dhe monitorohen kryesisht mbi bazë vjetore.

5. Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”

Qëllimi i këtij programi është: “Shërbim shëndetësor të specializuar mjekësor dhe spitalor në nivel universitar në trajtimin në rang kombëtar të politraumave.

Objektivat kryesor i këtij programi janë:

1. Pritja dhe trajtimi i pacientëve të politraumatizuar në kohë reale pranë urgjencës të SUT-së.

Treguesi i performancës për këtë objektivi:

- Numri i pacientëve të rishtruar për të njëjtën diagnozë;
- Koeficienti i shfrytëzimit të shtretërve;
- Koha e pritjes për ekzaminime të rëndësishme;
- Numri i vizitave ambulatorë;
- Numri i shtrimeve nga urgjenca.

2. Trajtimi shëndetësor dhe spitalor i pacientëve të afuara nga specialitetet mjekësore pranë SUT-së

Treguesi i performancës për këtë objektivi:

Numri i shtrimeve reanimatore;

- Numri total i operacioneve sipas specialiteteve;
- Numri i ekzaminimeve imazherike;
- Numri i ekzaminimeve laboratorike;
- Numri i vizitave ambulatorë në poliklinikë;
- Ditë qëndrimi mesatar në spital;
- Numri i urgjencave të kirurgjisë dhe terapisë;

- Numri i pacientëve të shtruar të planifikuar dhe urgjente në SUT;
- Numri i operacioneve të planifikuara dhe urgjente për çdo sallë operacioni.

Performanca e treguesve sa më sipër matet me bazë vjetore.

6. Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët”

Qëllimi i këtij programi është: Sigurimi dhe mbështetja financiare e ushtarakëve në rezervë dhe në lirim, trajtim të veçante të ushtarakëve të nëndetëseve në pension dhe pilotëve fluturues në pension. Përcaktimi, vlerësimi dhe planifikimi i përfituesve sipas këtyre kategorive.

Objektivi kryesor i këtij programi është:

Trajtim të veçantë të ushtarakëve, ushtarakëve të nëndetëseve në pension dhe pilotëve fluturues në pension.

Tregues i performancës:

-Numër përfituesish ushtarakë në rezervë dhe në lirim.

1,712 përfitues gra

Performanca e treguesve sa më sipër matet me bazë vjetore.

7. Programi “Emergjencat Civile”

Performanca jofinanciare e programit buxhetor

Qëllimi i këtij programi është: Mbrojtja e jetës së shtetasve, pronës së tyre, gjësë së gjallë, mjedisit, objekteve social-kulturore dhe të rëndësishme të veçantë, objekteve të trashëgimisë kulturore, infrastrukturës kritike etj., nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësi që shkaktohen nga veprimtari njerëzore, duke koordinuar veprimet e strukturave operacionale që kanë përgjegjësi në fushën e emergjencave civile.

Objektivat kryesorë të këtij programi janë:

Objektivi 1. Zvogëlimi i humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis.

- Tregues i performancës:
- Evakuime të kryera;
- Strehime të bëra;
- Ushqime të ofruara;
- Uji i pijshëm i pastruar;
- Higjienë personale e ofruar;
- Ndërhyrje në rast tërmeti të ofruara;
- Ndërhyrje në raste përmytjesh të ofruara;
- Ndërhyrje në raste zjarri të ofruara;
- Ndërhyrje në aksidente në det;
- Dezinfektime të kryera;

- Hospitalizime të bëra;
- Transporte të ofruara;
- Kilometra rrugë të pastruara etj.

Objektivi 2. “Rritja e stokut në mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore”

Tregues i performancës:

- Ton mallra ushqimore;
- Ton mallra industriale;
- Numër personash/familjesh që mund t’u vihet në ndihmë;
- Kohë gjatë të cilës mund t’u vihet në ndihmë rreth 4000 familjeve;
- Të ardhura të realizuara nga shitja e stokut të tepërt;
- Numër ankandesh të suksesshme të zhvilluara etj.

Për këtë program janë parashikuar objektiva specifike:

- Rritja e investimeve infrastrukturore me qëllim marrjen e masave parandaluese;
- Përmirësimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm;
- Rritja e kapaciteteve për ardhjen në ndihmë në rastet e fatkeqësive natyrore.

Treguesit e performancës për këto objektiva:

- Numri i investimeve të financuara;
- Numri i qytetarëve të ndihmuar në raste zjarri, përmytje dhe tërmeti.
- Numri i sistemeve paralajmëruese të vendosura në funksion.

Performanca e treguesve të mësipërm matet me bazë vjetore.

Theksojmë se për çdo program buxhetor nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt ka ndryshime në produktet që përfshijnë artikujt 600 dhe 601 “Shpenzime personeli” për shkak të ndryshimit të planit në krahasim me planin fillestar, për shkak të rritjes së pagave me VKM-të përkatëse.

Për informacion më të detajuar mbi sasi të produkteve të realizuara, koston faktike dhe deviacioneve të koston për njësi për çdo program buxhetor, lutemi referojuni Aneksit nr. 3: “Raporti i performancës së produkteve të programit”, Aneksit nr. 3.1: “Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve”, Aneksi nr. 3.2: “Deviacioni koston për njësi në vite” dhe Aneksi nr. 4: Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit”, të cilat i gjeni bashkëlidhur me materialin.

• **PROJEKTET KAPITALE**

Buxheti në total për vitin 2025 për projektet e investimeve është në vlerën **13,704,855 mijë lekë**, ndërsa realizimi është në vlerën **12,290,669 mijë lekë** ose në masën **90 %** (pa përfshirë kapitullin 6).

Sipas programeve buxhetore realizimi në mijë lekë paraqitet:

Nr.	Emërtimi i programit	Shpenzime kapitale (Fakti i vitit 2025)		Realizimi në
		Numri i projekteve të realizuara	Vlera	përqindje
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	5	77,654	100%
2.	Forcat e Luftimit	18	8,225,628	93%
3.	Mbështetja e Luftimit	23	2,069,971	89%
4.	Mbështetja për Shëndetësinë	2	193,285	98%
5.	Arsimimi Ushtarak	5	396,905	86%
6.	Emergjencat Civile	18	1,327,226	73%
	Totali i shpenzimeve të Ministrisë	71	12,290,669	90%

- Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi, realizimi është në masën 100% kundrejt planit vjetor të investimeve
- Forcat e Luftimit, realizimi është në masën 93% kundrejt planit vjetor të investimeve;
- Mbështetja e Luftimit, realizimi është në masën 89% kundrejt planit vjetor të investimeve;
- Mbështetja për Shëndetësinë, realizimi është në masën 98% kundrejt planit vjetor të investimeve;
- Arsimimi Ushtarak, realizimi është në masën 86% kundrejt planit vjetor të investimeve;
- Emergjencat Civile, realizimi është në masën 73% kundrejt planit vjetor të investimeve.

Sipas burimeve të financimit realizimi paraqitet:

- **Projektet me Financim të Brendshëm** janë në vlerën **13,704,855** mijë lekë, realizimi është në vlerën **12,290,669** mijë lekë ose në masën **90%** kundrejt planit vjetor të investimeve.
- **Projektet me Financim të Huaj** janë në vlerën **12,114,450** mijë lekë, realizimi është në vlerën 0 mijë lekë ose në masën **0%** kundrejt planit vjetor të investimeve, pasi këto fonde nuk janë detajuar në SIFQ.

Projektet me Financim të Brendshëm për vitin 2025 janë realizuar në masën 90%, dhe ky realizim ka ndikuar në rritjen e gatishmërisë operacionale të strukturave të Forcës Tokësore dhe numrin e personelit të mirëtrajtuar në kushte pune dhe stërvitje. Tregues që ndikojnë drejtpërsëdrejti në përbushjen e detyrimeve Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë dhe përbushjen e objektivave si vend anëtar i NATO-s, pasi dhe u arritën rezultatet e synuara, si më poshtë:

- U rrit përqindja e kompletimit me armatim e pajisje luftarake, kapaciteteve operacionale/resurseve të nevojshme për përballimin e situatave në vend dhe rajon;
- U përmirësua Sistemi i Vëzhgimit të Hapësirës Detare dhe Ajrore;
- U përmirësua infrastruktura hardware dhe software që synojnë të minimizojnë rreziqet gjatë fazave të projektimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve, reduktim të kostove operative, si dhe rritje efikasiteti dhe saktësie në vendimmarrje për Akademinë e Forcave të Armatosura;
- U përmirësua sistemi i sigurisë në reparte, u përmirësua niveli i mbështetjes operacionale për FA-në;
- U përmirësua infrastruktura ekzistuese me synim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.
- U rritën kapacitetet për përballimin e situatave emergjente me mallra industriale.

- U likuiduan detyrimet e prapambetura kundrejt qytetarëve të prekur nga fatkeqësitë natyrore, dosjet e të cilëve administroheshin nga AKMC-ja, duke ndikuar në lehtësimin e pasojave të fatkeqësive për 1000 familje;
- U blenë pajisje teknologjike dhe informatike për Akademinë e Forcave të Armatosura;
- U përmirësuan kushtet e punës për punonjësit në Forcën Tokësore dhe repartet e vartësisë, duke krijuar hapësira të reja dhe të rikonstruara sipas parametrave bashkëkohorë;
- U krijuan hapësirat e nevojshme për ruajtjen dhe magazinimin e armatim-municionit, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në rregullore të posaçme;
- U rrit përqindja e kompletimit me armatim e pajisje luftarake, kapaciteteve operacionale/resurseve të nevojshme për përballimin e situatave në vend dhe rajon;
- U krijuan ambiente të reja për administrimin e pajisjeve të kërkim-shpëtimit;
- U përmirësuan kushtet e punës së punonjësve, duke krijuar ambiente të reja sipas parametrave bashkëkohorë;
- U përmirësuan kushtet për ambientet stërvitore;
- U realizuan investimet në disa bashki të vendit, duke synuar zvogëlimin e rriskut për ndodhjen e fatkeqësive në këto zona;
- U përmirësua infrastruktura në software për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, duke ndikuar në krijimin e një database më të saktë të fatkeqësive natyrore për zonat e prekura nga fatkeqësitë dhe popullatës së ndikuar nga to;
- U përmirësuan kushtet e punës për QMC-të, duke rritur aftësinë e tyre reaguese në kushtet e emergjencës, si dhe gjatë ushtrimit të punës së tyre rutinë;
- U likuiduan detyrimet e përcaktuara në kontratat e projekteve me financim të huaj;
- U përmirësuan kushtet e punës për punonjësit, duke krijuar ambiente pune sipas parametrave bashkëkohorë;
- U rrit stoku rezervë shteti industrial, duke iu përafuar nomenklaturës së kërkuar nga legjislacioni në fuqi;
- U përmirësua sigurimi i sistemeve të armatimit, teknikës, pajisjeve të avancuara për të gjitha strukturat e parashikuara për angazhime në operacionet e NATO-s, BE-së, OKB-së etj.”
- U ofrua shërbimi arkivor ndaj qytetarëve institucioneve shtetërore e private, si dhe shërbimi për interesa studimore;
- U përmirësua ndjeshëm izolimi termik i objekteve, duke reduktuar humbjet e energjisë dhe kostot për ngrohje dhe ftohje;
- U siguroa furnizimi i qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike në Kampusin e ri të AFA-së.

Disa nga projektet e investimit që kanë përfunduar gjatë vitit 2025, mund të përmendim:

- Parku i mbyllur për mjete e blinduara;
- Ndërtim depo logjistike në R.U. nr.1030 Berat;
- Ndërtim godine shërbimesh 2 kate DMR Gjirokastrë;
- Ndërtim objekti shumëfunksional në Regjimentin e Operacioneve Speciale (ROS);
- Dylbi profesionale optike dhe për shikimin natën për repartet e Forcës Detare;
- Hangarë, mjedise për mirëmbajtjen, riparimin dhe testimin UAV;
- Hangarë për helikopterët Blackhawk;

- Blerje mjete speciale për AKMC-në;
- Ndërtim i 4 stacioneve hidrometeorologjike;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë realizuar 18 projekte investimi.

Me këtë investim u arritën rezultatet e synuara:

- Rritja e gatishmërisë operacionale të Forcave të Luftimit dhe përmbushjen e misionit kushtetues dhe objektivave të NATO-s;
- Përmirësimi i elementeve të ruajtjes dhe të sigurisë të Poligonit Kombëtar Pajet Bizë;
- U ngrit sistemi informatik për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave në kohë reale, si dhe rritja e saktësisë së tij.

Në projektet e modernizimit:

Projekti “Blerje armatim, municion, makineri e pajisje për Forcat e Armatosura” u zbatuan 6 projekte për kompletimin me armatim të lehtë, të mesëm dhe të rëndë, sipas kërkesave të standardizuara nga NATO-ja. Projekti ka ndikuar pozitivisht në rritjen e përqindjes së gatishmërisë operacionale në armatim e pajisje.

Projekti “Blerje dronësh”. Zbatimi i këtij projekti ka lindur si rezultat i zhvillimeve të fundit teknologjike në fushëbetejë në konflikte, referuar dhe gjeostategjisë në vendet e rajonit.

Projekti “Sistem i integruar i hapsirës ajrore”, vijimi i projektit me blerje radarësh të rinj është i rëndësishëm për rritjen e sigurisë dhe kontrollit të hapësirës ajrore.

Projekti “Ngritja e shkollës së aviacionit Vlorë”. Zbatimi i këtij projekti do të ndikojë në krijimin e kapaciteteve operacionale, shkolla e fluturimit ka rol të rëndësishëm në përgatitjen profesionale të pilotëve të rinj për misionet ajrore.

Projekti “Ndërtim i sistemit antidron”. Rëndësia e projektit të sistemit antidron C-UAS qëndron në mbrojtjen e hapësirës ajrore nga dronët e paautorizuar dhe kërcënimet e reja teknologjike.

Modernizim të stërvitjes ushtarake në atë virtuale (simuluese) Blerje 35 licenca VBS3 dhe 15 Laptopë për VBS3 (MTT)

Kompletimi me këto pajisje ka përmirësuar ndjeshëm rritjen e kapaciteteve operacionale/resurseve të nevojshme për përballimin e situatave në kohë paqe, elementet e ruajtjes dhe të sigurisë së personelit pjesëmarrës në stërvitje dhe transmetimit të informacionit të sigurt në përmbushjen e misionit, detyrave e objektivave të përcaktuara në dokumentet strategjike në fushën e mbrojtjes.

Disa nga projektet e investimit që kanë përfunduar në vitin 2025, mund të përmendim:

Ndërtimin/rikonstrukcionin:

U rikonstruktuan 2543 m² ambiente ekzistuese;

U ndërtuan dhe rikonstruktuan gjithsej 2543 m² ambiente, të cilat ndikojnë në akomodimin e personelit dhe ambienteve të ruajtjes dhe administrimit të aktiveve dhe armatim municionit.

U ndërtua rrjetit inxhinierik i Poligonit Kombëtar Pajet Bizë” është bërë e mundur ndërtimi i rrjetit infrastrukturor, duke krijuar mundësi akomodimi dhe zhvillimit normal të stërvitjes për një efektiv prej 1200 trupash të Forcave të Armatosura dhe vendeve anëtare të NATO-s, pjesëmarrëse në stërvitjet e përbashkëta shumëkombëshe.

U rikonstruktuan me sistem kapot pesë objekte në Qendrën e Arsimimit Profesional Ushtarak, Vlorë, përmes projektit “Veshje me sistem kapote për objektet e QAPU”, Bunavi – Vlorë;

U ndërtua kabina elektrike e Kampusin e ri të AFA-së, përmes projektit “Ndërtim i kabinës elektrike Masterplan AFA”.

Projekte të cilat nuk janë realizuar gjatë vitit 2025 janë:

- Robot nënujor për AKMC-në: Procedura ishte parashikuar për t’u realizuar në vitin 2025, po dështoi për shkak të vonesës në fillimin e procedurës nga OBP-ja;
- 18BA101- Blerje pajisje kompjuterike dhe fotokopje. Procedura ishte parashikuar për t’u realizuar në vitin 2025, po dështoi për shkak të mosrealizimit të procedurës nga AKSH-i;
- Investime të bashkive për Mbrojtjen Civile (sipas VKM 414, datë 08.07.2021);
- Blerje ushqimi për gjënë e gjallë;
- Ndërtim i godinës së re shumëfunktionale të AFA-së;
- Kompletimi me pajisje dhe orendi të dy godinave të masterplanit;
- Kompletimi me pajisje informatike dhe teknologjike të dy godinave të masterplanit (fakultetit dhe mensës) TIK”;
- Pasurimi me literaturë të bibliotekës së AFA-së

Gjatë vitit 2025 ka pasur mospërputhje mes ecurisë fizike të projekteve me planin e financimit, për arsye prokurimi dhe problematikave me lejet zhvillimore mjedisore dhe miratimit të projekteve.

Gjatë vitit 2025 investimet e zbatuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë paraqitur problematika, të cilat kanë të bëjnë me ecurinë fizike dhe procedurale të tyre. Vonesa të cilat kanë ndikuar në realizimin në një nivel më të ulët të investimeve dhe rritjen e detyrimit për t’u financuar në vitin pasardhës, situatë e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në pakësimin e fondeve në dispozicion për financimin e projekteve të reja.

Gjatë vitit 2025 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura në projektet e investimeve.

INVESTIMET E HUAJA

Krahasuar të dhënat në Sistemin Informatik Financiar Qeveritar (SIFQ) me vlerat e pasqyruara në ligjin e buxhetit 115/2024, “Për buxhetin 2025”, evidentohet ndryshimi (pakësimi) në “Shpenzimet kapitale me financim të huaj në shumën 12,114,450 mijë lekë”. Ndryshimi në buxhet për shpenzime kapitale me financim të huaj paraqitet pakësim në shumën 97,600 mijë lekë. Këto projekte nuk kanë plan të miratuar dhe nuk raportohen nëpërmjet sistemit të thesarit.

Në programin “Forcat e Luftimit” shtesë në shpenzime kapitale në shumën 902,400 mijë lekë në projektin me kod 18AZ208 “Kapacitete të ofruara në modernizim”. Në programin “Emergjencat Civile” pakësim në shpenzime kapitale në shumën 1,000,000 mijë lekë.

Për artikullin 602 “Mallra e Shërbime” u mbështetën me fonde financiare për:

- U përballuan shpenzimet për ushtarakët aktivë që shërbejnë në shtabe të NATO-s dhe atashetë ushtarakë;
- U ble karburanti për Forcat e Armatosura;
- U krye furnizimi dhe shërbimi me ushqim për mensat dhe kompensimin financiar të ushqimit;
- U riparuan dhe u mirëmbajtën helikopterët për Komandën e Forcës Ajrore;
- U trajnuan pilotët dhe personeli që menaxhon avionët pa pilot të Forcës Ajrore;
- U riparuan dhe u mirëmbajtën anijet për Komandën e Forcës Detare;
- Shpenzime për misionet paqeruajtëse ndërkombëtare;
- U përballuan shpenzimet për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura në udhëtime brenda dhe jashtë vendit;
- U përballuan shpenzimet për stërvitje të përbashkëta etj.
- U trajtuan rreth 62,984 urgjenca/të shtruar te spitali i traumës, si dhe raste ambulatore.
- U mbuluan shpenzimet për emergjencat civile nëpërmjet zërit “Ndërhyrje infrastrukturore për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe blerje pajisje për mbrojtjen civile;
- U trajtuan si kategori përfitues të pensioneve suplementare të ushtarakëve **31,790 persona**.

TË ARDHUARAT E TRASHËGUARA JASHTË PLANIT LIMIT (KAP. 6)

Në total të ardhurat jashtë planit limit për 12-mujorin e vitit 2025, janë në shumën **202,277 mijë** lekë të detajuara për artikujt ekonomikë përkatës, si më poshtë:

Në 000 lekë

GR..	Programi	Fakti sipas sistemit të Thesarit				Totali
		KAP	600	602	231	
17	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	6		24,637	115,450	140,087
17	Forcat e Luftimit	6		933	2,211	3,144
17	Mbështetja e Luftimit	6		599	16,478	17,077
17	Arsimimi Ushtarak	6	671	3,742	0	4,413
17	Mbështetja për Shëndetësinë	6	3274	4,985	21929	30,188
17	Emergjenca Civile	6	0	3,637	3,731	7,368
TOTALI			3,945	38,533	159,799	202,277

Informacion mbi detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi janar - dhjetor 2025

Detyrimet e prapambetura e të krijuar rishtazi për periudhën janar-dhjetor 2025, të raportuara nga njësitë shpenzuese të Ministrisë së Mbrojtjes, janë në vlerën rreth 214,396 mijë lekë.

Gjatë vitit 2025 me fondet e akorduara të këtij viti, janë likuiduar nga AKMC-ja detyrimet në artikullin 604, për përballimin e fatkeqësive natyrore në shumën 150,206 mijë lekë, duke e zbritur vlerën e detyrimeve të prapambetura në 26,993 mijë lekë.

Për vitin 2025 janë bërë kërkesat përkatëse në fazën II, të Programit Buxhetor Afatmesëm 206-2028, por referuar analizave të realizimit të pritshëm të buxhetit, do të shihet mundësia e rialokimit të fondeve midis artikujve, me qëllim likuidimin total të detyrimeve të prapambetura.

• **NDRYSHIMET NË BUXHET**

Ndryshimet në buxhet për vitin 2025 janë:

Në total ministrie, ndryshimi i buxhetit për këtë periudhë paraqitet me ulje në vlerën **11,226,628** mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar, sipas artikujve buxhetorë në mijë lekë:

	Plani fillestar	Plani me ndryshime	Shpenzime faktike	Diferenca (Gjendja)	Përqindja e realizimit	Ndryshime në buxhet
TOTAL MINISTRIA E MBROJTJES	8,866,684	10,594,510	10,536,589	57,921	99	-1,727,826
	1,526,300	1,774,860	1,757,113	17,747	99	-248,560
	7,333,836	8,455,164	8,252,993	202,171	98	-1,121,328
	0	0	0	0	0	0
	6,000,000	5,868,230	5,819,089	49,141	99	131,770
	293,424	251,424	251,390	34	100	42,000
	516,250	664,430	634,933	29,497	96	-148,180
	15,937,000	13,704,855	12,290,669	1,414,186	90	2,232,145
12,212,050	12,114,450	0	12,114,450	0	97,600	
Përfshirë 231 me financim të huaj	52,685,544	53,427,923	39,542,775	13,885,148	74	(742,379)
Investimi me financim të brendshëm	40,473,494	41,313,473	39,542,775	1,770,698	96	(839,979)

Shkresat në të cilat pasqyrohet ndryshimi i buxhetit për vitin 2025 janë:

Shkresat në të cilat pasqyrohet ndryshimi i buxhetit në artikullin 231 “Investime” për vitin 2025 janë:

- Shkresa e Ministrisë së Financave nr. 5252/1, datë 09.04.2025, me lëvizje të fondeve në njësinë shpenzuese AKMC për projektin “Fatkeqësi natyrore të menaxhuara”.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr. 5519/1 prot., datë 09.04.2025, me lëvizje të fondeve në kuadër të VKM nr.127 dhe VKM nr.128, datë 28.02.2025 për fondet e bashkive, si dhe “Parandalimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore” në vazhdim dhe të reja.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr. 6530 prot., datë 14.04.2025 “Saktësim Kodi projekti” i VKM nr.127 dhe VKM nr.128 datë 28.02.2025 për fondet e bashkive dhe “Parandalimi dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore”.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr. 5905/1 prot., datë 25.04.2025, pakësim 33,000 mijë lekë te Komanda Mbështetëse dhe shtesë 33,000 mijë lekë tek Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, brenda programit buxhetor (02150).

- Shkresa e Ministrisë së Financave nr. 8571/1 prot., datë 29.05.2025, pakësim 1,570 mijë lekë njësia shpenzuese Forca Detare dhe shtesë 1.570. mijë lekë te Forca Ajrore, brenda programit buxhetor (02150).
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr. 9636/1, datë 25.06.2025, lëvizje brenda njësisë shpenzuese Komanda Mbështetëse me vlerën 5,000 mijë lekë, si dhe rishpërndarje midis projekteve të AKMC, brenda programit buxhetor 10910.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr. 9326/112 prot., datë 28.07.2025, “Mbi zbatimin e AN nr.6 datë 11.06.2025”.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.12056/1 prot., datë 13.08.2025, lëvizje brenda njësisë shpenzuese Forca Tokësore me vlerën 16.000 mijë lekë programi 02120.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.14505/45 prot., datë 30.10.2025 “Mbi zbatimin e AN nr.10 datë 08.10.2025 dhe MM nr.6299 datë 31.10.2025.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.15480/1 prot., datë 05.11.2025, rishpërndarje midis bashkive në vlerën 10,805 mijë lekë, brenda programit buxhetor 10910.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.15890/1 prot., datë 12.11.2025, rishpërndarje midis bashkive në vlerën 6,720 mijë lekë, brenda programit buxhetor 10910.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.16408/2 prot., datë 15.12.2025, rishpërndarje brenda projekteve njësisë shpenzuese Komanda Mbështetëse me vlerën 3,000 mijë lekë, si dhe rishpërndarje brenda projekteve të AKMC-së dhe bashkive në vlerën 35,200 mijë brenda programit buxhetor 10910.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.1859/103, datë 31.12.2025 “Mbi zbatimin e AN nr.11 datë 19.12.2025 dhe MM nr.7739, datë 31.12.2025.

Shkresat në të cilat pasqyrohet ndryshimi i buxhetit shpenzime korrente (600 - 606) për vitin 2025 janë:

- Në artikullin 600 “Pagë dhe shtesa mbi pagë”, artikullin 602 “Mallra dhe Shërbime” dhe 606 “Transferta familjare” me shkresën e MF nr. 7 100/1, datë 13.05.2025 dhe shkresën e MM nr.1926/2, datë 28.04.2025.
- Artikullin 606 “Transferta familjare”, shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 6049/1, datë 11.04.2025, “Dërgohet miratimi i detajimit të fondit të veçantë për vitin 2025”.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.10459/1, dt.24.07.2025 dhe shkresë MM nr.4294 dt.25.07.2025, pakësim fondi 14,000 mijë lekë (606) dhe shtesë 14.000. mijë lekë, në art. (602) për njësinë shpenzuese QPR (1017122).

- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.9326/112 prot., datë 28.07.2025, “Mbi zbatimin e AN nr.6 datë 11.06.2025”.
- Në artikullin 601 “Sigurime Shoqërore” dhe 606 “Transferta familjare”, me shkresën e MF nr.10645/1, datë 16.07.25, dhe shkresën e MM nr.3783/1, datë 07.07.2025, pakësim 25,000 mijë lekë (1017081) 601 dhe shtesë 25,000 mijë lekë 606 brenda programit 09430.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr. 13591/1, datë 30.09.25, shkresa e MM nr.5301/1, datë 22.09.2025, pakësim 35,000 mijë lekë (1017001) 605 dhe shtesë 35,000 mijë lekë tek 602 brenda programit 01110.
- VKM nr. 483 datë 02.09.2025, shkresa e Ministrisë së Financave nr.13426/1, datë16.07.25, shkresa e MM nr. 5301/1, datë 29.09.2025, shtesë fondi prej 145,810 mijë lekë në programin buxhetor (02120), shtesë 43,408 mijë lekë, në programin buxhetor (02150) dhe 3,922 mijë lekë programi (10910).
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.13426/4, datë 10.10.2025, shkresa e MM nr. 5802, datë.13.10.2025, pakësim 30,668 mijë lekë (1017031) 605 dhe shtesë 30,668 mijë lekë në art. 602 brenda programit (02120).
- VKM 540 datë 29.09.2025, shkresa e Ministrisë së Financave nr. 14607/2, datë 27.10.2025, shkresa e MM nr.6219, datë 28.10.2025, shtesë 28,958 mijë lekë në art. 604 njësia shpenzuese (1017086).
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.14505/45, datë 30.10.2025 “Mbi zbatimin e AN nr.10, datë 08.10.2025 dhe MM nr.6299, datë31.10.2025.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.16408/8, datë 21.11.2025, lëvizje prej 20,800 mijë lekë në art. (600-602) tek programi (02150).
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.16528/1, datë15.12.2025, shtesë fondi 28,306, mijë lekë në art. 606 “Dërgohet miratimi i detajimit të fondit të veçantë shtesë për vitin 2025”, për të gjitha programet buxhetore.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.1859/103, datë 31.12.2025 “Mbi zbatimin e AN nr.11, datë 19.12.2025 dhe MM nr.7739, datë31.12.2025.
- Pakësimi në shpenzime kapitale me financim të huaj, në shumën 97,600,000 mijë lekë.

Siç dhe u sqarua gjatë këtij relacioni, realizimi i buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes është në nivel shumë të mirë dhe nga ana jonë është ndjekur me përgjegjësi menaxhimi i fondeve.

Në mosrealizimin e buxhetit në masën 100%, ndër shkaqet kryesore përmendim:

Mungesat në organikë, mosrealizim të procedurave të prokurimit në shpenzimet për mallra e shërbime dhe investimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, mosrealizimi i të cilave është përtej kompetencave të MM-së. Lidhur me investimet e menaxhuara nga bashkitë është vënë re se një pjesë e mirë e tyre

Nga ana jonë janë punuar në mënyrë manuale anekset, aneksi nr.1, aneksi nr. 1.1 aneksi nr. 1.2 aneksi nr. 2, aneksi nr. 2/1 dhe Aneksi nr. 3. Për të dhënat financiare (Plan dhe Fakt) anekset janë plotësuar manualisht për shpenzimet e Ministrisë së Mbrojtjes dhe janë të rakorduara me të dhënat e nxjerra nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) për vitin 2025. Të ndodhur në këto kushte është i pamundur plotësimi manualisht i tabelave voluminoze, aneksi nr. 3.1, Aneksi nr. 3.2 dhe aneksi nr. 4 “Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit”, treguesit e performancës monitorohen mbi bazë vjetore. Jemi në pritje të njoftimit nga Ministria e Financave për fillimin e funksionit të sistemit AFMIS, me qëllim përditësimin e të dhënave nga programet buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes.

Siç dhe u sqarua gjatë këtij relacioni, realizimi i buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes është në nivel shumë të mirë dhe nga ana jonë është ndjekur me përgjegjësi menaxhimi i fondeve.

Në mosrealizimin e buxhetit në masën 100%, ndër shkaqet kryesore përmendim:

Mungesat në organikë, mosrealizim të procedurave të prokurimit në shpenzimet për mallra e shërbime dhe investimet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, mosrealizimi i të cilave është përtej kompetencave të MM-së. Lidhur me investimet e menaxhuara nga bashkitë është vënë re se një pjesë e mirë e tyre realizojnë proceset e prokurimit dhe lidhjes së kontratave në fund të vitit buxhetor dhe për rrjedhojë realizimi i vitit aktual paraqitet i ulët dhe kërkesa për fonde, me qëllim mbulimin e investimeve në proces për vitin e ardhshëm, është më e lartë.

Raportet e monitorimit janë publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM